



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 2 nëntor 2015
Nr. ref.:RK850/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI121/14

Parashtrues

Valdet Nikçi dhe të tjerët

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të
Kosovës, Rev. nr. 21/14, të 3 prillit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Valdet Nikçi, Nimon Dinaj, Isuf Vukli, Fazli Kuçi, Shkëlzen Morina, Sutkije Boja, Nusret Kurtaj, Shqipe Dakaj, Nimon Shala, Sejdi Camaj, Kimete R. Kastrati, Ramadan Morina, Hedije Dupa, Qazim Qavolli, Nekibe Morina, Nusret Belegu, Mybera Tigani, Hajdin Vermezi, Mevlyde Kullashi, Ferid Dupa, Hale Smakaj, Isuf Dreshaj, Kimete Kastrati, Besim Ademaj, Vjollca Kelmendi, Hazir Jonuzi, Sylejman Laja, Emin Sylejmani, Mustafë Ahmeti, Qerim Rama, Xhevat Berisha, Sejdi Durmishi, Deli Shala, Rexhë Nikçi, Sudan Krasniqi, Rifat Shala, Imer Blakaj, Xhevat Daci, Hysen Dreshaj, Shefki Seferaj, Shyqri Jashari, Rifat Zekaj, Jakup Shala, Shaban Kelmendi, Ejup Bojupi, Haki Gashi, Ali Shala, Shaban Dakaj, Rifat Kuçi, Xhevdet Shala, Bislim Lajçi, Nimon Kastrati, Lutfo Rebronja, Isa Gashi, Hazir Beqiri, Muzli Ukshinaj, Rexhep Tishuku, Bilall Durmishi, Daut Berisha, Skënder Rexhëbogaj, Skënder Krasniqi, Hajrullah Zhara, Ahmet Muriqi, Ramiz Kastrati, Dinë Kuçi, Rrustem Elshani, Bajram Bobi, Çelë Nikçi, Xhevat Gashi (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës). Punëtorët përfaqësohen nga z. Valdet Nikçi, i cili është kryetar i Sindikatës së Fabrikës së Konstruksioneve Metalike (ish-UTVA) në Pejë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 21/14, i 3 prillit 2014 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).
3. Parashtruesit e kërkesës nuk e kanë specifikuar datën se kur e kanë pranuar aktvendimin e lartpërmendur të Gjykatës Supreme.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të lartpërmendur.
5. Parashtruesit pretendojnë se me vendimet e gjykatave të rregullta u janë shkelur: neni 21 [Parimet e Përgjithshme], neni 24 [Barazia para Ligjit], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës, si dhe u janë shkelur të drejtat e garantuara me Ligjin e Procedurës Kontestimore dhe me Ligjin e punës.
6. Kërkesa e parashtrueseve ka të bëjë me kompensimin e pagave të papaguara nga ana e Fabrikës së Konstruksioneve Metalike (ish-UTVA) në Pejë, duke përfshirë periudhën kohore prej 1 qershorit 1995 e deri më 31 mars 1999.

Baza juridike

7. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

8. Më 23 korrik 2014, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata)
9. Më 6 gusht 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. 121/14, caktoi gjyqtarin Altay Suroy, gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. 121/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
10. Më 12 shtator 2014, z. Valdet Nikçi dorëzoi autorizimin për përfaqësimin e parashtruesve në Gjykatë.
11. Më 17 shtator 2014, Gjykata informoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës KI121/14, dhe një kopje e saj iu dërgua Gjykatës Supreme.
12. Më 5 dhjetor 2014, Gjykata kërkoi disa informata shtesë nga parashtruesit e kërkesës.
13. Më 12 dhjetor 2014, parashtruesit e kërkesës i dorëzuan në Gjykatë informatat shtesë.
14. Më 25 shkurt 2015, Gjykata kërkoi nga parashtruesit që të kompletinin kërkesën dhe ta plotësonin formularin zyrtar të kërkesës.
15. Më 9 mars 2015, parashtruesit e kërkesës dorëzuan në Gjykatë formularin e kërkesës.
16. Më 29 qershor 2015, Kryetarja, me Vendimin KSH. KI121/14, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi anëtare të Kolegjit shqyrtues, në vend të gjyqtarit Enver Hasani, mandati i të cilit si gjyqtar kushtetues kishte përfunduar më 26 qershor 2015.
17. Më 8 shtator 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

18. Parashtruesit e kërkesës kanë qenë në marrëdhënie pune në Fabrikën e Konstruksioneve Metalike në Pejë. Sipas parashtruesve, fabrika në fjalë nuk ua kishte kompensuar atyre pagat mujore prej 1 qershorit 1995 e deri më 31 mars 1999, periudhë kjo kur ata u larguan dhunshëm nga puna.
19. Parashtruesit ngritën padi në Gjykatën Komunale në Pejë kundër Fabrikës së Konstruksioneve Metalike në Pejë (ish-UTVA).
20. Më 27 tetor 2004, Gjykata Komunale në Pejë, nxori Aktgjykimin C. nr. 133/03, me ç'rast aprovoi paditë e parashtruesve dhe e detyroi Fabrikën e Konstruksioneve Metalike në Pejë (e paditura), që t'ua paguajë atyre pagat mujore të papaguara prej 1 qershorit 1995 e deri më 31 mars 1999 . Më tej në

Aktgjykim theksohet: “Bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar si dhe në faktet jo kontestuese në mes pjesëmarrësve në procedurë, gjykata konstatoi se kërkesëpaditë e precizuara të paditësve kanë bazë juridike e si të tilla gjykata i aprovoi si të bazuara”.

21. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Pejë, Fabrika e Konstruksioneve Metalike në Pejë (ish-UTVA) nuk kishte ushtruar ankesë.
22. Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: AKM), nëpërmjet Prokurorit Publik të Shtetit, parashtrroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit C. nr. 133/03, të Gjykatës Komunale të Pejës.
23. Më 22 mars 2005, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi Mlc. nr. 2/2005), refuzoi, si të pabazuar, kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, me arsyetimin se Gjykata Komunale në Pejë ka pasur juridiksion për të vendosur për paditë në pajtim me Ligjin mbi Gjykatat e Rregullta (Nr. 21/1978) dhe se ka përcaktuar drejt faktet dhe në mënyrë të drejtë ka aplikuar ligjin procedural dhe atë material.

Faktet sipas kërkesës për përsëritje të procedurës

24. Në një datë të pacaktuar, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP-ja) parashtrroi kërkesë për përsëritje të procedurës në Gjykatën e Qarkut në Pejë.
25. Më 22 nëntor 2010, Gjykata e Qarkut në Pejë, me Aktvendimin Ac. nr. 390/2010, hodhi poshtë kërkesën për përsëritjen e procedurës, përkitazi me lëndën C. nr. 133/03, që ishte vendosur nga Gjykata Komunale e Pejës, më 27 tetor 2004.
26. Kundër Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut të Pejës, AKP-ja ushtroi ankesë në instancën e dytë në të njëjtën gjykatë.
27. Më 21 mars 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë (instanca e dytë) nxori Aktvendimin K. Ac. nr. 4/10, me të cilin prishi aktvendimin e instancës së parë të Gjykatës së Qarkut të Pejës dhe vendosi që lëndën t’ia kthejë instancës së parë për rishqyrtim dhe për rivendosje.
28. Më 20 prill 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë (instanca e parë) nxori Aktvendimin AC. nr. 141/2011, me të cilin lejoi përsëritjen e procedurës së përfunduar me Aktgjykimin (C. nr. 133/03, e 27 tetorit 2004) e formës së prerë të Gjykatës Komunale në Pejë, duke e anuluar në tërësi aktgjykimin.
29. Parashtruesit, kundër Aktvendimit (Ac. nr. 141/2011) të Gjykatës së Qarkut të Pejës, me të cilin ishte lejuar kërkesa për përsëritjen e procedurës, kishin ushtruar revizion në Gjykatën Supreme.
30. Më 3 prill 2014, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktvendimi, Rev. nr. 21/2014), hodhi poshtë, si të palejuar, revizionin e ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë.

Faktet sipas procedurës kontestimore

31. Pas lejimit të përsëritjes së procedurës nga Gjykata e Qarkut në Pejë (instanca e dytë), Gjykata Themelore në Pejë *ex officio* filloi rishqyrtimin e lëndës, e cila u regjistrua me nr. C. nr. 254/11.
32. Më 2 qershor 2014, AKP-ja kërkoi ndërprerjen e procedurës kontestimore përkitazi me lëndën C. nr. 254/11, e cila pritej të shqyrtohej nga Gjykata Themelore në Pejë.
33. Më 23 korrik 2014, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, për të cilin fakt parashtruesit e njoftuan edhe Gjykatën Themelore në Pejë.
34. Më 3 shtator 2014, Gjykata Themelore në Pejë vendosi për ndërprerjen e procedurës kontestimore. Në bazë të procesverbalit të gjykatës në fjalë thuhet: *“Shtyhet seanca për kohë të pacaktuar ndërsa data e seancës së ardhshme do të caktohet pasi që Gjykata Kushtetuese të vendos lidhur me ligjshmërinë e aktvendimit të Gjykatës Supreme...”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

35. Parashtruesit pretendojnë se me vendimet e gjykatave të rregullta u janë shkelur: neni 21 [Parimet e Përgjithshme], neni 24 [Barazia para Ligjit], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës, si dhe u janë shkelur të drejtat e garantuara me Ligjin e Procedurës Kontestimore dhe me Ligjin e punës.
36. Parashtruesit në Gjykatë ngritën edhe çështjet si në vijim:
 - *A është palë në procedurë në rastin konkret AKM, përkatësisht AKP-ja?*
 - *A ka pasur të drejtë Gjykata e Qarkut ta pranon kërkesën për përsëritjen e procedurës, sipas kërkesës së AKP-së, pas kalimit të afatit 5 vjeçar pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit C. Nr. 133/03 dhe atë në kohën e likuidimit të ndërmarrjes, ndërsa tani vet kërkon ndërprerjen e procedurës për shkak të likuidimit-ndërmarrja gjendet në procedurën e likuidimit?*
 - *Sipas të gjitha provave të parashtruara a kanë të drejtë punëtorët të iu bëhet kompensimi i pagave të papaguara për punën e bërë për periudhën e cekur në padi dhe Aktgjykimin e GJK. C. nr. 133/03.*

Pranueshmëria e kërkesës

37. Për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesve, Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesit i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
38. Gjykata, në këtë rast, i referohet nenit 113. 7 të Kushtetutës, që përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

39. Përveç kësaj, neni 47.2 i Ligjit, parasheh:

“Individi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi ti ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

40. Për më tepër, rregulli 36 (1) (b) i Rregullores së punës parasheh:

“Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me ligj kundër vendimit ose aktgjykimit të kundërshtuar”.

41. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Gjykata Themelore në Pejë, më 3 shtator 2014, me kërkesë të AKP-së, vendosi për pezullimin e procedurës kontestimore përkitazi me lëndën C. nr. 254/11, derisa Gjykata Kushtetuese të nxjerrë vendim, sipas kërkesës së parashtruar nga parashtruesit.

42. Gjykata, duke u bazuar në faktin që rasti i parashtruesve të kërkesës është ende në shqyrtim e sipër në procedurë të rregullt gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Pejë, konsideron se kërkesa e parashtruesve është e parakohshme.

43. Në këtë rast, Gjykata rithekson se gjykatat e rregullta janë të pavarura në ushtrimin e pushtetit të tyre gjyqësor dhe se është obligim i tyre kushtetues që të interpretojnë çështjet faktike dhe të ligjit që janë relevante për rastet e ngritura para tyre.

44. Parimi i shterimit të mjeteve efektive juridike, si në rastin konkret, është që t'u ofrohet gjykatave të rregullta mundësia e rregullimit të shkeljeve të pretenduara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese (Shih Aktvendimin për papranueshmëri, *AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*, KI41/09, të 21 janarit 2010, dhe shih *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës*, nr. 25 803/94, Aktvendim i 28 korrikut 1999).

45. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi i kërkesës t'i shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, administrative ose gjyqësore, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka, të korrigjohet shkelja e tillë e të drejtave themelore. (Shih Aktvendimin në Rastin KI07/09, *Demë Kurbogaj dhe Besnik Kurbogaj*, Vlerësim i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 61/07, të 24 nëntorit 2008, paragrafi 18).

46. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese nuk mund të vlerësojë shkeljet e pretenduara kushtetuese, para se gjykatat e rregullta që t'i përfundojnë procedurat që janë shtruar para tyre.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, në përputhje me nenin 20 të Ligjit dhe me rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës, 8 shtator 2015, njëzëri:

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në përputhje me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Altay Suroy



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi